



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1619, datë 22.06.2011

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 1564¹, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun me pakicë i Linjave me Qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.06.2011, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 1564, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun me pakicë i Linjave me Qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira”,

¹ Albtelecom në Ankimin Administrativ i referohet Aktit (“Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun me pakicë i Linjave me Qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira”), si Vendimi nr.1364, datë 13.04.2011. AKEP sqaron se referenca e saktë për këtë Akt është: Vendimi nr.1564, datë 13.04.2011. Numri 1364 i Vendimit i pasqyruar në tekstin e Vendimit të publikuar dhe dokumentin e analizës ka qënë lapsus teknik dhe është korrigjuar tashmë nga AKEP.

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*K.Pr.A*);
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (*Rregullorja e Brendshme*);
4. “Rregullore për analizën e tregut”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 747, datë 17.07.2009 (*Rregullorja*);
5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (*Rregullorja*);
6. Vendimi 1564, datë 13.04.2011 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun me pakicë i Linjave me Qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira” (*Vendimi nr. 1564*),

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 2453 prot, datë 20.05.2011 e Albtelecom sh.a (AKEP nr. 591/5 prot, datë 23.05.2011), (*Ankim Administrativë*);
2. Vendimi nr.1564, datë 13.04.2011 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun me pakicë i Linjave me Qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira” (*Vendimi nr. 1564*);
3. Projektvendim i KD të AKEP për Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 1564, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun me pakicë i Linjave me Qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira” (*Projektvendimi*);
5. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*);
si dhe,
6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Albtelecom me shkresën nr. 2453 prot, datë 20.05.2011 (AKEP nr. 591/5 prot, datë 23.05.2011) brënda afatit ligjor të përcaktuar ne nenin 140 të Ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativë për shfuqizimin e Aktit Administrativ Vendimi nr. 1564, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit

- Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun me pakicë i Linjave me Qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira”;
2. Albtelecom sh.a nëpërmjet Ankimit Administrativë bazuar në nenin 138 të K.Pr.A kërkon pezullimin e zbatimit të Vendimit nr. 1564 dhe shfuqizimin e tij;
 3. Albtelecom argumenton se, në zbatim të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, konsultimet publike për analizën e tregjeve dhe ai për përcaktimin e masave rregullatore duhet të zhvillohen njëri pas tjetri. Periudha 60 ditore për Albtelecom, i përket vetëm dokumentit të analizës për përmbajtjen e saj. Në përfundim të kësaj periudhe AKEP, publikon dokumentin final së bashku me komentet e palëve si dhe propozon masat rregullatore të cilat miratohen pas procesit të këshillimit publik të parashikuar në pikën 2 të nenin 36 të Ligjit nr. 9918, proces i cili kryhet në zbatim të nenit 110 të Ligjit nr. 9918;
 4. Albtelecom thekson se, gjendet përballë vështirësive dhe pamundësive objektive për implementimin dhe realizimin e njëkohshëm të të gjitha detyrimeve të cilat bien ndesh me një nga parimet e kuadrit rregullator europian dhe të Ligjit nr. 9918, se vendosja e detyrimeve nuk duhet të jetë barrë e tepërt për operatorin;
 5. Albtelecom konsideron se, në zbatim të nenit 1 të Ligj nr. 9918 i cili shpreh qartë parimin e asnjësisë teknologjike për promovimin dhe infrastrukturës efçente për të garantuar ofrimin e shërbimeve, ofrimi i linjave me qira është plotësisht e mundur edhe nga operatorë të tjerë, vëçanërisht nga Vodafone Albania i cili, duke disponuar licesën për përdorimin e teknologjisë 3G nuk ka asnjë pengesë strukturore në ofrimin e këtij shërbimi;
 6. Gjithashtu Albtelecom e konsideron të pa bazuar qëndrimin e AKEP se Albtelecom ka avantazhe për shkak të mbulimit kombëtar me rrjet, për shkak se Albtelecom ndodhet në të njëjtën situatë me operatorët mobile për rrjetin *backbone* dhe mundësimin e segmenteve terminuese;
 7. Albtelecom vëren se, në analizat për tregjet e zhvilluara nga AKEP theksohet se me gjithë eliminimin e pengesave ligjore për hyrjen në treg ekzistojnë pengesa strukturore që lidhen me investimet në infrastrukturë që u duhen operatorëve alternativë për ofrimin e shërbimeve të caktuara të cilat merren në analizë, arsyetim i cili është në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit qëllimi i të cilit është promovimi i infrastrukturës efçente dhe gërma dh) e pikës 3 të nenit 7, si dhe Rek. 2007, sipas të cilit AKEP nxit konkurrencën për të nxitur investimet efçente në infrastukturën e komunikimeve elektronike;
 8. Albtelecom i referohet praktikave europiane si rasti EIRCOM, për të cili Doc.ComReg 08/63,2008 arësyeton se me gjetjen e EIRCOM me FNT, në tregun e shumicës së linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese, këto masa janë të arsyeshme për konkurrencën efçente në tregun me pakicë të linjave me qira, pasi nuk ka asnjë barrier për hyrjen në treg. Në këtë mënyrë Rek 2007² ka bërë një rivlerësim të tregjeve për rregullim ex-ante dhe nga analiza ka rezultuar se tregu me akicë i linjave me qira nuk plotëson kriteret për tu listuar në tregjet që kanë nevojë për rregullim ex-ante dhe se ndërhyrja në nivel shumice është e mjaftueshme për tregun e pakicës;
 9. Albtelecom në lidhje me klientët kryesore të linjave me qira si Bankat apo Institucionet Shtetërore, shpjegon se kjo kategori klientësh është e përqëndruar

- kryesisht në Tiranë, dhe se ka një sërë operatorësh të cilët kanë investuar në ndërtimin e rrjetit urbanë dhe kanë ofruar edhe linja me qira;
10. Për sa më sipër Albtelecom konsideron se sjellja e Albtelecom në treg nuk ka dekurajuar hyrjet në treg, investimet apo fitimet e këtyre shërbimeve;
 11. Albtelecom argumenton se vërtet ka mbulim pothuajse kombëtar por nuk është prezent në shumë zona rurale ku operatorët kanë ndërtuar rrjetet e tyre, dhe në zonat ku Albtelecom nuk është prezent dhe operatori alternativ ka rrjetin e tij, ky operatorë duhet gjetur me fuqi të ndjeshme në treg pasi klienti kërkues nuk ka mundësi tjetër zgjedhjeje si dhe nuk ka forcë negociuese për çmimin;
 12. Albtelecom në lidhje me qëndrimin e AKEP se ky treg nuk ka nevojë për analizën e tre kritereve sepse është i listuar në rregulloren për analizën e tregut, e konsideron atë të pabazuar dhe në kundërshtim me ligjin i cili prevalon ndaj rregullores së AKEP, ndërkohë që Rek 2007 shprehet se për tregjet jo të listuara janë autoritetet kombëtare ato që duhet të analizojnë nëpërmjet 3 kritereve tregjet që kanë nevojë për rregullim ex-ante, por kjo duke patur parasysh kushtet dhe rrethanat kombëtare të tregjeve përkatëse;
 13. Albtelecom mbi disa probleme të evidentuara nga AKEP në ofrimin e linjave me qira sqaron se:
 - Albtelecom nuk ka patur diferencim në ofrimin e linjave me qira kur është kërkuar nga çdo klient;
 - Afatet e realizimit të kërkesave nuk kanë kaluar më shumë se 14 ditë kalendarike nga pranimi i kërkesës;
 - Albtelecom ka ofruar vazhdimisht qarqe të pjesshme me qira ndaj operatorëve për interkoneksionin e ndërmjetëm dhe aplikimi i formulës për pagesat e qarqeve e cila redukton pagesat e qarqeve me pakicë;
 - Informacioni mbi tarifën dhe kapacitetet e linjave me qira gjenden në faqen e internetit të Albtelecom dhe çdo klient i paraqitur pranë ambjenteve të Albtelecom i ofrohet informacioni i kërkuar nga shtafi përkatës;
 - Produkti më i shitur qark 2 mbit/sek ofrohet me tarifa shumë më të ulëta se benchmarku EU;
 - Albtelecom garanton cilësinë e ofrimit të shërbimeve duke vendosur klauzolat përkatëse në kontratën për ofrimin e shërbimit dhe nuk ka patur raste të ankesave për cilësinë e ofruar;
 14. Albtelecom mbi tarifën e përcaktuara në Vendim vëren se, referencat e këtyre tarifave në rezultatet paraprake të modelit BU_LRAIC, për të cilën Albtelecom nuk ka dijeni dhe nuk është njohur me përmbajtjen e këtij dokumenti;
 15. Për sa më sipër, Albtelecom nëpërmjet këtij ankimi administrativ kërkon shfuqizimin dhe pezullimin e zbatimit të aktit administrativ Vendimit nr. 1564, datë 13.04.2011 të AKEP, si dhe pranimin ankimit administrativ sipas kërkesës së Albtelecom sh.a;
 16. AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrativë, në lidhje me Vendimin nr. 1565, datë 13.04.2011 të AKEP, gjykon se:

- a. Në lidhje me pretendimin e Albtelecom për procedurën e konsultimit publik për FNT dhe masat rregulluese, AKEP konsideron se praktikata e mbajtura deri tani në lidhje me të gjitha analizat e tregjeve janë në përputhje me kudrin ligjor dhe rregullator, ndaj sugjerimi i bërë nga Albtelecom për këtë, gjykohet se nuk është arsyetuar drejt. Së bashku me dokumentin e konsultuar janë dhënë edhe propozimet përkatëse në lidhje me masat rregullatore, të cilat kanë kryer procesin e konsultimit së bashku me dokumentin e analizës dhe në versionin final të analizës, duke përfshirë edhe komentet e ardhura mbi dokumentin e analizës si dhe trajtimeve të mundshme që mund të bëhen në dokumentin final, do të këtë vendimarrje edhe në lidhje me masat rregullatore që do të përcaktohen, në analogji të plotë me të gjitha praktikata e mëparshme të procesit të analizave. Në mbështetje të kësaj Albtelecom mund të gjejë referenca në dokumentin e Analizës si dhe Vendimin nr.1030, datë 17.11.2009, të KD të AKEP, për nxjerrjen në konsultim publik të Analizës ku në pikën 2 citohet: *Procedura e konsultimit publik për dokumentin e analizës së tregut si dhe detyrimeve të propozuara për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, të kryhet, nga data 23.11.2009 deri më 23.01.2010.* Kjo praktikë është në vijimësi e ndjekur nga AKEP me të gjitha analizat e tregjeve të kryera dhe konsiderohet një praktike jo vetëm ligjore por edhe më e arsyeshme, duke qenë se për çdo masë rregullatore të propozuar në dokumentin e konsultuar, në raport me problemet e identifikuar si dhe argumentet e përdorur në analizë, propozimi edhe i masës rregullatore përkatëse do të kuptohesh me drejt nga palët e interesuara. Kështu që edhe në këtë rast, kjo analizë nuk ka ndonjë arsye të veçantë për të ndjekur një praktike të ndryshme nga praktikata e mëparshme, përveç faktit që është hera e parë që sugjerohet një gjë e tillë dhe se vetë sugjerimi nuk sjell ndonjë risi në këtë drejtim. Përcaktimet e Ligjit nr. 9918, detyrojnë AKEP që të konsultojë analizën për FNT dhe masat rregulluese por nuk detyrojnë AKEP që të bëjë konsultime të veçanta për to: një për FNT dhe një për masat rregulluese;
- b. Në lidhje me pretendimet e Albtelecom për tregun me pakicë të linjave me qira dhe referencat me rekomandimin e KE 2007 si dhe praktika në vende të BE, sqaron se sipas rregullores së analizës së tregut, lista e tregjeve e përfshin këtë treg dhe nuk është e nevojshme që të kryhet testi i 3 kriterëve. Gjithashtu AKEP në Vendimin nr. 1564 (pika 4.4.2/II) për FNT ka lejuar që Albtelecom të propozojë nivelin e tarifave me pakicë: *Për tarifimin e qarqeve kombëtare dixhitale me pakicë Albtelecom mund të aplikojë tarifa të cilat nuk mund të jenë më të lira se tarifatat me shumicë në tabelën e mësipërme. Albtelecom, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij duhet të sjellë propozimin në AKEP, për tarifatat me pakicë të linjave me qira kombëtare.* Kjo liri për Albtelecom do të lejojë edhe eliminimin e disa problemeve në strukturën tarifore të linjave me qira me pakicë, të pranuar edhe nga Albtelecom;
- c. Për sa i përket komenteve për interpretimin e pengesave ligjore, AKEP nuk është shprehur se ekzistojnë pengesa ligjore (pasi ato janë eliminuar) por pengesa strukturore si ekonomitë e shkallës, dendësisë etj. Megjithatë operatorët e tjerë kanë zhvilluar rrjetet e tyre, ata nuk mund të krahasohen me Albtelecom. Gjithashtu segmentimi i zonave gjeografike sipas zonave ku kanë prezencë operatorët e tjerë nuk është jo vetëm praktik por edhe nuk

plotëson kriteret për një ndarje të tillë. Altelecom mund të mos ketë presencë në zonat rurale por kjo nuk do të thotë që nuk ka mundësi të hyje në këto zona. Gjithashtu edhe masat rregulluese marrin në konsideratë mundësitë teknike të Altelecom, pra shërbimi ofrohet nëse ekzistojnë mundësitë teknike të Altelecom;

- d. Në lidhje me komentin për nxitjen e investimeve eficientë, theksojmë se AKEP me vendimin për dhënie akses në linjat me qira me shpërndarje nga Altelecom, synon pikërisht nxitjen e investimeve eficientë nga sipërmarrësit. Masat rregulluese marrin në konsideratë investimet kryera nga Altelecom dhe tarifatat e vendosura nuk janë nën-kosto por në kostot BULRAIC që nxisin investimet eficientë si dhe lejojnë Altelecom një normë të arsyeshme fitimi;
- e. Në lidhje me komentin për tarifatat sipas kostove BULRAIC, AKEP sqaron se në pikën 4.4.2 të vendimit të ankimit citohet: *Tarifatat e mësipërme do të jenë në varësi të vendimit të AKEP pas konsultimit publik për orientimin në kostot BULRAIC të tarifave të Altelecom.* Nga ky citim është e qartë se niveli i këtyre tarifave sipas rezultateve të modelit BULRAIC do të jenë pjesë e një konsultimi publik të veçantë që do të kryejë AKEP. Tarifatat e dhena në Vendimin nr.1564, datë 13.04.2011, do të jenë në fuqi deri në ndryshimin e tyre me një vendim tjetër të AKEP;
- f. Në lidhje me barrën rregullatore të implementimit të shumë detyrimeve në të njëjtën kohë AKEP vë në dukje se masat e vendosura ndaj Altelecom janë të arsyeshme dhe nuk përbëjnë barrë të tepërt rregullatore. Kujtojmë se detyrimet e vendosura për linjat me qira dhe LLU po vendosen për herë të parë ndaj Altelecom por në vendet anëtare të BE këto detyrimeve ndaj operatorit inkumbent kanë filluar të aplikohen shumë vite më parë,

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 2453 prot, datë 20.05.2011 të Altelecom sh.a. në lidhje me Vendimin nr.1564, datë 13.04.2011 të KD të AKEP;
2. Lënie në fuqi të Vendimit nr. 1564, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun me pakicë i Linjave me Qira (grupi minimal) dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira”;
3. Të njoftohet sipërmarrësi Altelecom sh.a për zbatimin e këtij Vendimi;

4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

- 1. Alketa MUKAVELATI**
- 2. Benon PALOKA**
- 3. Ibsen ELEZI**
- 4. Zamira NURCE**